

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

UNIVERSITETIT TË IOWA

KOLEGJI I DREJTËSISË ¹

Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës (“Akademia Diplomatike”) dhe Universiteti i Iowa-s, Kolegji i Drejtësisë, (“Kolegji i Drejtësisë i Iowa-s”) (këtej e tutje bashkërisht të referuar si “Palët”), kanë rënë dakord siç vijon:

Neni 1

Qëllimi

Në vazhdim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë Diplomatike dhe Klinikës Ligjore Ndërkombëtare të Kolegjit të Drejtësisë të Iowa-s të lidhur më 2 Shtator 2014, dhe Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Universitetit të Iowa-s dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme më 10 Shtator 2015, pikësynimi i këtij i Memorandumi të Mirëkuptimit është krijimi i kushteve për mbajtjen e kontakteve të rregullta, duke promovuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ndërsjellë të njohurive ndërmjet Palëve.

Neni 2

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve

Palët bien dakord të bashkëpunojnë për vizita studimore, kurse të specializuara dhe praktika, në fushat e së Drejtës Ndërkombëtare, Organizatave Ndërkombëtare, Aderimit në Konventat Ndërkombëtare dhe Traktate, si dhe në kurse tjera relevante dhe të specializuara.

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

Kolegji i Drejtësisë i Iowa-s pajtohet për të mirëpritur dhe për të siguruar pajisjet për zyrë, siç është hapësira për tavolinë pune dhe lidhje të internetit, për çdo vizitor përfaqësues të Akademisë Diplomatike.

Neni 3

Shkëmbimi i Literaturës dhe Ligjëratave

Palët bien dakord për të mbështetur dhe lehtësuar shkëmbimin e ndërsjellë të literaturës, duke përfshirë ato në formë të printuar dhe elektronike.

Palët bien dakord për të siguruar qasje në bibliotekat e njëri tjetrit dhe materialeve që gjenden brenda bibliotekave.

Palët do të mbështesin dhe ndihmojnë njëri tjetrin përkitazi me ligjëratat për të cilat kanë rënë dakord në ambientet e Akademisë Diplomatike.

Neni 4

Konferencat dhe Aktivitetet e Përbashkëta

Palët do të promovojnë dhe do të bashkëpunojnë në krijimin e konferencave dhe aktiviteteve të përbashkëta, relevante me objektivat e marrëdhënieve ndërmjet Palëve.

Palët do të informojnë reciprokisht njëra tjetrën mbi kushtet, datat dhe programet e ngjarjeve të ardhshme të përbashkëta.

Neni 5

Analiza e Çështjeve

Palët do të mbështesin dhe do të bashkëpunojnë në hulumtime si dhe në analiza për çështje specifike. Në veçanti, Akademia Diplomatike mund të kërkoj që Kolegji i Drejtësisë i Iowa-s të zhvilloj analiza dhe hulumtime, dhe Kolegji i Drejtësisë i Iowa-s do të përcaktoj nëse ka në dispozicion ekspertizë dhe burime për të rënë dakord për kërkesën.

Neni 6

Kushtet Financiare

Asgjë në këtë Memorandum të Mirëkuptimit nuk nënkupton që të kërkoj nga cilado Palë për të marrë përsipër burimet financiare. Për formën, kohëzgjatjen dhe kushtet financiare të çdo aktiviteti të parashikuar në këtë Memorandum të Mirëkuptimit, do të bihet dakord paraprakisht ndërmjet Palëve.

Neni 7 Ndryshimet

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur me interpretimin ose zbatimin e Memorandumit do të zgjidhen ndërmjet Palëve nëpërmjet konsultimeve.

Dispozitat e Memorandumit mund të ndryshohen përmes pëlqimit reciprok me shkrim të Palëve.

Neni 8 Të Drejtat e Njeriut dhe Mos-diskriminimi

Është politikë e Universitetit të Iowa dhe Akademisë Diplomatike të garantoj të drejtat themelore të studentëve të tyre dhe fakultetit duke hyrë në marrëveshjet e këmbimit vetëm me institucionet procedurat e përzgjedhjes për aplikim të së cilave janë të bazuara vetëm në nivelin e aftësisë dhe cilësisë së performancës së kandidatëve.

Të dyja Palët pajtohen me politikën e mundësive të barabarta dhe mos-diskriminimit. Universiteti i Iowa dhe Akademia Diplomatike do të veprojnë në përputhje me këto parime në administrimin e kësaj marrëveshjeje, dhe asnjëri institucion nuk do të imponoj kritere për shkëmbimin mësuesve apo studentëve të cilët do të shkelnin parimet e mos-diskriminimit siç janë të pasqyruara në Politikën e të Drejtave të Njeriut të Universitetit të Iowa-s. Universiteti i Iowa-s dhe Akademia Diplomatike rezervojnë të drejtën për të ndërprerë këtë marrëveshje në çdo kohë nëse shkeljet e këtyre politikave kanë rënë në vëmendjen e tyre dhe janë konfirmuar.

NENI 9 Hyrja në Fuqi

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet i vlefshëm, përveç nëse ndonjëra palë njofton tjetrën me shkrim të paktën tre muaj përpara, për synimin e saj për ta ndërprerë.

Bërë në Iowa City, më 8 Dhjetor 2015, në dy kopje origjinale, në Gjuhën Angleze.

NËNSHKRIMET

Për Akademinë Diplomatike,
Ministria e Punëve të Jashtme,
Republika e Kosovës

Skender Durmishi
Drejtor

Për Universitetin e Iowa-s

Gail B. Agrawal
Dekan, Kolegji i Drejtësisë

Downing A. Thomas
Rektor Kolegë dhe Dekan
i Programeve Ndërkombëtare